



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Mbledhja:** Nr. 17

**Datë:** 18. 03. 2024

**Fillimi i takimit:** Ora: 13:30

**Vendi:** Selia e KQZ-së/ Prishtinë

**Kryesoi:** Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

**Anëtarët e KQZ-së prezentë:** Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

**Nga SKQZ:** Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 15/2024**
- 3. Aktivitetet e SKQZ**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Listës Preliminare të Votuesve;
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
- 3.Njoftimit për ndërrimin e qendrës së votimit, kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;

## **5. Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Fillimisht, kryetari Radoniqi e paraqiti agjendën e mbledhjes. Anëtarët e KQZ-së, pa ndonjë ndryshim, miratuan me 11 vota, agjendën e takimit. Pastaj, në pikën e dytë, anëtarët me 10 vota për dhe një abstenim ( Čemailj Kurtiš), e miratuan procesverbalin nr. 15/2024: Aktivitetet e SKQZ.

### **2. Aktivitetet e SKQZ**

**Burim Ahmetaj**, e paraqiti raportin e Sekretariatit mes dy takimeve, dhe tha se prioritet tani është funksionalizimi i zyrove në katër komunitat ku do të mbahet votimi i 21 prillit. Në bazë të kompetencave, kemi marrë vendim për caktimin e këtyre zyrtarëve:

Në komunën e Mitrovicës së Veriut, është caktuar zyrtar, ZKZ nga komuna e Gracanicës, ndërsa që zyrtari i ZKZ nga Mitrovica e Jugut, do ta ndihmoj zyrën në Mitrovicën e Veriut.

Në komunën e Zveçanit, është caktuar zyrtar, ZKZ nga komuna e Shtërpces, ndërsa që zyrtari i ZKZ nga zyra në Ferizaj, do ta ndihmoj zyrën në këtë komunë.

Në komunën e Zubin Potokut, është caktuar zyrtar, ZKZ nga komuna e Ranillukut, ndërsa që zyrtari i ZKZ nga zyra në Kamenicë, do ta ndihmoj zyrën në këtë komunë.

Në komunën e Leposaviqit, është caktuar zyrtar, ZKZ nga komuna e Parteshit, ndërsa që zyrtari i ZKZ nga zyra në Novobër, do ta ndihmoj zyrën në këtë komunë. Nga sot, planifikojmë të fillojmë aktivitetin. Aktivitetet që lidhen me këtë proces, raportoi z. Ahmetaj, janë: Publikimi i Listës Preliminare të Votuesve në platformën elektronike fillon më 18 mars dhe përfundon më 19 mars 2024; Zbatimi i Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit të LV-së fillon më 18 mars dhe përfundon më 05 prill 2024; Kërkesa dhe Pranimi i Ekstraktit të dytë të Rregjistrimit Qendror Civil nga ARC-ja fillon më 21 mars dhe përfundon më 25 mars 2024; Hartimi i procedurave zgjedhore dhe Dizajnimi i formularëve zgjedhor fillon më 13 mars dhe përfundon, më 27 mars 2024.

**Kreshnik Radoniqi**, pyeti nëse ka dicka lidhur me këtë pyetje.

Gordana Llaban, u interesue rreth shifres “1,103 personave të angazhuar”...? U tha se, kjo është në pikën e radhës, dhe sqarohet..

### **3. Raport i Këshillave të KQZ:**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

##### 1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Listës Preliminare të Votuesve:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ ka shqyrtuar Listën preliminare të votuesve. Në këtë proces votimi, për të katër komunat, janë 46, 248 qytetarë me të drejtë vote – në tërësi. Z. Elshani, paraqiti raportin e votuesve për secilën komunë. Në krahasim me votimin e fundit në prill të vitit të kaluar, numri i votuesve është rritur për “1153” votues. Dhe kjo ndodh për shkak se personat e ri votues, kanë mbushur 18 vjec, dhe ata kanë fituar të drejtën për votim. Konsiderojmë që, kjo listë të votohet.

Me 8 vota për, dhe 3 abstenime ( Ilir Gashi, Arianit Elshani dhe Gordana Llaban) u miratua Lista Preliminare e Votuesve

##### 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

**Arianit Elshani**: KOZ, tha z. Elshani, ka shqyrtuar edhe këtë pikë. QV-të, mbesin të njëjta sepse në mars të vitit të kaluar, në nivel vendi kemi miratuar listën e QV. Do të jenë qendra në hapësirat publike-institucionale. Rekomandojmë për aprovim.

Me 11 vota për, u miratuan Qendrat e Votimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

##### 3.Njoftimit për ndërrimin e qendrës së votimit, kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së:

**Arianit Elshani**, në këtë pikë të KOZ-it, tha se do të bëhet një “njoftim” për të gjithë, dhe se lidhur me këtë do të zhvillohet një fushatë informimi publik, në media, në rrjetet sociale, në ueb faqen e KQZ. Kjo, për të

sensibilizuar për qytetarët mundësinë e “ndërrimin e qendrës së votimit, kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së”.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Edhe në këtë pikë, **Arianit Elshani** tha se në KOZ është shqyrtuar rekomandimi për emërimin e KKZ-ve për këtë proces të votimit në katër komuna. Për secilën komunë ka nominime të KKZ-ve, të subjekteve politike. Kështu, në komunën e Leposaviqit janë 5 nominime, në komunën e Zubin Potokut janë 4 nominime ,në komunën e Zveçan janë 4 nominime, dhe Mitrovicë e Veriut janë 6 nominime...

**Alban Krasniqi**, theksoi se janë edhe dy ditëve afat dhe se, mund të ketë edhe plotësime të tjera. Në parim, mund ta votojmë rekomandimin...

Kryetari **Radoniqi**, pyeti se kush është për miratim.

Me 10 vota për, dhe një abstenim (Gordana Llaban), u mirtrua rekomandimi për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

Lista e personave, ti bashkangjitet vendimit, kërkoi z. Radoniqi.

**Të ndryshme!**

**Sami Kurteshi**, pyeti rreth numrave të telefonit për komunikim. Ndërsa, **Burim Ahmetaj** tha se, janë ndërmarrë masa, dhe numri është aktiv...